

Mal Berisha

ROLI I FEDERATËS PAN-SHQIPTARE VATRA NË  
MBROJTJEN E KUFIJVE DHE PAVARESINË E SHQIPËRISË  
PARA DHE GJATË KONFERENCËS SË PAQES NË  
PARIS, 1919.

*(Kumtesë e mbajtur në Simpoziumin e mbajtur për nder të 90 vjetorit  
të daljes së gazetës "Dielli")*

*Southern Gate Hotel, Nju Jork, 30 Tetor 1999)*

ROLI I FEDERATËS PAN-SHQIPTARE 'VATRA' NË MBROJTJEN E KUFIJVE  
DHE PAVARESINË E SHQIPËRISË PARA DHE GJATË KONFERENCËS SË  
PAQES NË PARIS, 1919.

*(Kumtesë e mbajtur në Simpoziumin e mbajtur për nder të 90 vjetorit të daljes së gazetës  
"Dielli", Nju Jork 30 Tetor 1999)*

Vatra dhe Dielli kanë luajtur një rol të tillë në historinë e Shqipërisë sa që është zor ta krahasosh me ndonjë tjetër. Ato janë pjesë e shpirtit dhe mendjes shqiptare e cila la atdheun në kushtet e rrethanat që dihen por pa e harruar kurrë atë. Në fakt kjo ndarje e dhimbshme e atyre që e frymëzuan dhe e ndërjuan Vatrën dhe Diellin vazhdon të coptojë zemrën e shumë e shumë të tjerëve të cilët edhe sot e gjithë dita vazhdojnë ta lëshojnë atdheun, jo pse nuk e duan atë por sepse kushtet dhe rrethanat ua diktojnë këtë.

Do të desha të ndalem në rolin që ka luajtur VATRA jonë dhe organi i saj DIELLI në ruajtjen e territoreve etnike shqiptare dhe formimin e shtetit shqiptar gjatë dhe pas Luftës së Parë Botërore dhe sidomos në Konferencën e Paqes në Paris.

Siç dihet, pas shpalljes së pavarësisë me 1912, Fuqitë e Mëdha e trajtuan çështjen shqiptare si një mjet për të plotësuar egot e veta ose për të ruajtur paqen midis tyre duke iu falur territore nga tokat shqiptare fqinjëve që në thelb ishin lëshime sa për armiqtë e Shqipërisë aq edhe për interesat e tyre.

Në vitin 1913 u mbajt Konferenca e Ambasadorëve në Londër e cila la jashtë territorit të shtetit shqiptar gjysmën e vendit, madje mund të thuhet ato pjesë të cilat kishin luajtur një rol përcaktues për heqjen e zgjedhës osmane. Kjo padrejtësi historike nuk mjaftoi ose nuk i kënaqi qarqet anti-shqiptare dhe kështu më 1915 mbahet Traktati i Fshehtë i Londres i cili synon t'u shpërndajë fqinjëve edhe atë pak territor që i mbeti Shqipërisë, ku tani Italia po ashtu pretendonte të merrte Vlorën me rrethina duke plotësuar ëndrrën e vjetër italiane për ta kthyer Detin Adriatik në një Liqen Italian nëpërmjet Otrantos.

Pikërisht në një situatë të tillë, pra në vigjilje të coptimit të plotë të territoreve shqiptare, Vatra dhe Dielli treguan pjekurinë dhe përgjegjësinë më të madhe për kombin e tyre dhe u hodhën në një betejë shembullore për mbrojtjen e atdheut.

Lidhur me qëndrimin e Vatrës dhe organit të saj "Dielli" është folur dhe shkruar shumë. Por unë do të ndalem shkurtazi në trajtimin që i kanë bërë kësaj çështje tre autorë jo-shqiptare të cilët kanë botuar tre libra shembullorë për Historinë e Shqipërisë. Që të tre e kanë trajtuar rolin e Vatrës dhe të Diellit duke iu referuar shtypit të kohës dhe dokumenteve historike.

1.- **Edwin Jacques**, autor amerikan në librin e tij "Shqiptarët, një Histori Etnike prej Kohëve Para-Historike deri në Kohët Moderne" Botuar në ShBA - Tetor 1995.<sup>1</sup>

Ky autor i cili jep një përshkrim historik të gjenezës shqiptare dhe zhvillimin e këtij kombi deri në ditët e sotme është ndaluar tek roli që luajtën shqiptarët e Amerikës në demaskimin e intrigave të fuqive europiane dhe në formimin e shtetit të tyre shqiptar e veçanërisht në rolin që luajtën në Konferencën e Paqes në Paris. Libri i Edwin Jacques ka sjellë citime të shumta nga arshivat në Washington por unë do të ndalem tek disa prej tyre:

"Shqiptaro-Amerikanet e Bostonit u mblodhën në një tubim historik me 4 Nëntor 1915 për t'i dërguar një peticion Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës që të formonin një fond ndihmash ushqimore për të ndihmuar popullatën shqiptare e cila po vdiste nga uria si rezultat i bllokadës italiane të bregut të detit shqiptar pas Traktatit të Fshehtë të Londrës i cili i jepte Italisë Vlorën. Në këto ditë të vështira të mbijetesës së popullit shqiptar ishte peshkopi Fan Noli i cili lëshoi apelin poetik, "**Jepni për Nënë**" duke nxitur djemtë besnikë të shqipes që të kontribonin me 150.000 dollarë për ndihma për Shqipërinë çka ishte një shumë kuptimplotë po të kihet parasysh situata e atëhershme dhe vlera e monedhës.

Një ndër kontributet më të mëdha historike të Vatrës sigurisht mbeten marrdhëniet e krerëve të saj me Presidentin Uillson. Me datën 4 Korrik 1918 Peshkopi Noli, i cili përfaqësonte Federatën Pan - Shqiptare Vatra si dhe përfaqësues të tjerë kombesh të vogla e shoqëruan Presidentin Uillson në Jahtin Presidential Mayflower për tek varreza e Gorge Washingtonit në Malin Vermon. Në këtë datë të shënuar, presidenti Uillson deklaroi 14 principet e nacionalizmit dhe vetëqeverisjes së kombeve të vogla. Më pas Fan Noli u takua me Presidentin në Mayflower për të folur në emër të pavarësisë së Shqipërisë. Në atë takim Presidenti Uillson i tha Fan Nolit: ***Unë do të kem vetëm një zë në Konferencën e Paqes dhe atë zë do ta përdor në emër të Shqipërisë.***

Presidenti ishte i impersionuar thellë nga telegramet dhe letrat që kishte marrë nga shqiptarët për pavarësinë dhe ruajtjen e territorit të Shqipërisë.

Konferenca e Paqes e njohu Shqiperinë si një komb me vetëqeverisje të ligjëshme brenda kufijeve të vendosur më 1913 dhe i urdhëroi ushtritë e vendeve fqinjë që të largoheshin menjëherë prej territorit të saj. Fan Noli, si përfaqësuesi i Vatrës deklaroi: ***"Presidenti Uillson bëri më shumë se askush tjetër për pavarësinë e Shqipërisë; Uillsoni refuzoi kategorikisht të nënshkruante marrëveshjen deri sa u siguria në të drejtën vetë-qeverisëse të shqiptarëve"***.

Se sa cinik ka qënë rregjimi komunist në Shqipëri kur deklaronte se i vetmi rregjim që i mbrojt të drejtat e kombeve të vegjël ishte ai sovjetik i udhëhequr nga Lenini, është e lehtë të kuptohet.

Nuk ka asnjë dyshim së roli i Vatrës dhe organit të saj Dielli ka qënë përcaktues në qëndrimin e ShBA - ve në atë kohë dhe posaçërisht Presidentit Willson në të ardhmen e Shqipërisë ose më mirë të themi, në vetë ekzistencën e shtetit shqiptar.

2.- **Harris Silajxhic** në librin i cili e ka bërë doktor të shkencave historike: "**Shqipëria dhe shqiptarët në Arkivat e Washingtonit**"<sup>2</sup> ka dhënë një pasqyrë të shkëlqyer të luftës

<sup>1</sup> **Edwin E. Jacques** – THE ALBANIANS An Ethnic History from Prehistoric Times to the Present, McFarland & Company, Inc – Publishers Jefferson, North Carolina, and London.

dhe përpjekjeve që intelektualët shqipëtarë dhe vatanët në SHBA kanë bërë për mbrojtjen e pavarësisë së Shqipërisë dhe formimin e shtetit shqiptar. Zoti Silajxhiç mund të themi se ka arritur të na japë me dashamirësi orientimin përfundimor e veçanërisht orientimin pro-amerikan të shqiptarëve çka është një nder për ne dhe një goditje për pseudo-historianët të cilët kërkojnë ta identifikojnë kombin shqiptar me një komb të prapambetur e të paorientuar si duhet.

Në këtë libër autori ka arritur të nënvizojë aftësinë e vatanëve për ta rreshtuar vendin e tyre në krah të palës së fituar si dhe krijimin e miqve të cilët e duan Shqipërinë. Dhe këta miq janë gjetur e gjënden gjithnjë në ShBA.

Në librin e tij, Zoti Silajxhiç i ka kushtuar një vëmendje shumë të madhe ndikimit të Vatrës mbi delegacionin amerikan në Konferencën e Paqes dhe rrjedhimisht qëndrimin amerikan për këtë çështje. Për këtë ai iu është referuar gazetës Dielli dhe shumë burimeve të tjera të botuara. Megjithëse vatanet nuk arritën t'ia nbushnin mendjen Presidentit Amerikan që ta merrte Shqipërinë nën një protektorat amerikan, prapëseprapë roli i Vatrës në mbrojtjen e kufijve të përcaktuar me 1913 nga një coptim i mëtejshëm mbetet historik.

Vatanët e drejtuan luftën e tyre në këto drejtime kryesore:

- 1- Në bindjen e delegacionit amerikan mbi drejtësinë e kërkesave shqiptare.
- 2- Në diskretitimin e propogandës armiqësore anti-shqiptare e sidomos asaj greke sipas së cilës të tërë ortodoksët e Jugut të Shqipërisë janë grekë.
- 3- Gjallërimin e jetës politike në atdhe.

Detyra bazë e emigrantëve shqiptarë në Amerikë të grumbulluar rreth Vatrës ishte që të demonstrojnë se shqiptarët e besimit ortodoks që jetonin në Shqipërinë e Jugut ose ata që kishin ardhur në Amerikë nga ajo zonë nuk janë grekë. Shqiptarët e Amerikës të shqetësuar nga deklaratat e Venizellosit dhe Politisit u dërgojnë nëpërmjet Mehmet Konicës një telegram udhëheqësve të katër Fuqive të Mëdha në të cilat tregojnë vendosmërinë e tyre në favor të çështjes shqiptare. Në atë mbledhje morën pjesë 124 priftërinj ndër ta edhe rumunë me origjinë nga Korça, çka ishte një përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj presionit të Patriarkanës Greke ndaj popullsisë ortodokse shqiptare në Shqipërinë e Jugut.

Këtu vlen të përmendet edhe një telegram i Dr. Mihal Turtullit në emër të Federatës Pan-Shqiptare Vatra, dërguar Presidentit Uillson ku i jep fakte rreth fallcitetit të thënieve greke rreth numrit të grekëve në Jug të Shqipërisë. Në vorbullën e intrigave anti-shqiptare të grekëve dhe qarqeve të tjera, Federata Pan-Shqiptare Vatra luajti një rol të pazëvendësueshëm në sqarimin e identitetit të kombit shqiptar, përkatësisht të banorëve shqiptarë të zonave që synohej të coptohehin.

Në një letër drejtuar Presidentit Uillson vatanët e krishterë shkruanin:

"Ne të poshtëshënuarit, të krishterë ortodoksë, të lindur në këtë pjesë të Shqipërisë të cilin disa e quajnë Epir të Veriut, protestojmë energjikisht kundër deklaratave të

<sup>2</sup> **Harris Silajxhiç**, është i pari politikan dhe lider nga ish - Jugosllavia që një pjesë të jetës e ka kaluar mbi arkivat për të zbardhur historinë e Shqipërisë. Ka botuar një libër historik për marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Amerikës, që atij i ka dhënë titullin "Doktor i Shkencave", dhe ne na ka treguar një pjesë të panjohur të së kaluarës tonë.

Z.Karapanos. Situata në të cilën gjënden banorët e besimit kristian nuk dallon aspak nga situata në të cilën gjëndet pjesa tjetër e bashkëatdhetarëve tanë. Të krishterë dhe muslimanë, bij të të njëjtit atdhe, që flasin të njëjtën gjuhë, që kanë të njëjtat ndjenja dhe interesa dhe që gjithmonë kanë punuar së bashku për të njëjtën çështje: Terësinë tokësore dhe pavarësinë e Shqipërisë. Ato jo vetëm që nuk kanë pranuar pushtimin e Shqipërisë nga trupat greke, por sapo kujtojnë genocidin e pashembullt grek mbi shqiptarët të kryer gjatë vitit 1914 u dridhet zemra nga tmerri."

Vatranët kanë meritën e madhe sepse i ofruan për herë të parë delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris të drejtën për të dëshmuar në Komitetin e Marrëdhënieve me Jashtë në Senatit Amerikan. Ekspozën para Senatit e ka bërë njeri ndër anëtarët aktiv të Federatës Pan-Shqiptare Vatra, Konstandin Çekrezi (anëtar i Kolegjiut të Universitetit Kolumbia) i cili pasi paraqiti shkurtimisht Historinë e Shqipërisë iu kërkoi senatorëve që të përqëndroheshin veçanërisht në Shqipërinë e Jugut. Ai e akuzoi Unionin Pan-Epirot për fallsifikim të nënshkrimeve në memorandumit që kjo organizatë i kishte dërguar Konferencës. Ai akuzoi pjesmarrësit në Konferencë se çështjen e Shqipërisë po e përdornin si një objekt kompensimi për çështjet e tyre.

Kristo Dako po ashtu akuzoi Greginë për gjithçka që kishte bërë duke dëshmuar për masakrat e kryera ndaj shqiptarëve dhe kërkoi komision hetimi në vend, i cili të vendoste për fatin e Shqipërisë.

Merita e Vatrës qëndron tek fakti se ajo arriti të bënte që ShBA të bllokonte vënien në jetë të Traktatit të Fshehtë të Londrës. Pra vatranët arritën ta bindin Presidentin Uillson për drejtësinë e kauzës së tyre.

Idetë e Vatrës për orientimin e Shqipërisë dhe të shqiptarëve janë shprehur më së miri nëpërmjet kryetarit të atershëm të Vatrës, Fan Noli, i cili kërkonte një komision amerikan si i vetmi i paanshëm për të ndihmuar shqiptarët për krijimin dhe vënien në efikasitet të një shteti ku çdo shqiptar besnik të ndjehej i kënaqur. Noli ishte i sigurtë se shumë shqiptarë që ishin detyruar të emigronin në Amerikë kanë dëshirë të kthehen në atdhe dhe të japin ndihmesën në zhvillimin e tij dhe "me futjen e koncepteve amerikane të lirisë, ekonomisë dhe zhvillimit politik" ta futin Shqipërinë në rrugën e rilindjes ekonomike dhe kulturore. Institucionet arsimore amerikane, sipas mendimit të Nolit, do të ishin "*shpëtim për Shqipërinë, duke patur parasysh se kultura anglosaksone i përshtatet më mirë shpirtit puritan të racës shqiptare*".

Bie pra në sy se çfarë orientimi donte që t'i jepte Vatra zhvillimit të ardhshëm politik e ekonomik. Shqiptarët e Amerikës nën drejtimin e Vatrës arritën që të kenë një influencë të jashtëzakonshme tek përfaqësuesit amerikan në Konferencë. Ata luftuan për ta patur Amerikën një mandatore. Në mënyrë të veçante ra në sy roli i amerikanit Çarls Telford Erikson<sup>3</sup> i cili insistoi shumë për një mandat të tillë amerikan.

**3-Charles Telford Erickson** ka lindur në 1867 në Galensburg të Illinoisit, nga prindër suedeze. Pas diplomimit në Universitetin e Bostonit dhe pas një viti të kaluar në Burma, Erikson për disa vjet shërbeu si pastor në kishat e Ohajos dhe më vonë kaloi tre vjet në Yale University ku mori një diplomë masteri në vitin 1902. Më pas ai shërbeu si pastor në Kenktikat derisa u emerua drejtor i një misioni i "American Board of Foreign Missions" në Shqipëri në vitin 1908. Erikson shërbeu në Bordin Amerikan për dymbëdhjetë vjet dhe vazhdoi në mënyrë të pavarur edhe për katërbëdhjetë vjet të tjera. Gjatë luftës së parë botërore, Erikson punoi si zyrtar i Kryqit të Kuq në Itali dhe më pas u zgjodh delegat i nderit në Konferencën e Paqës në Paris nga Federata e Shqiptarëve të Amerikës dhe nga qeveria e përkohshme shqiptare. Në Delegacionin shqiptar në Versajë ai foli dhe protestoi kundër padrejtësive, duke kërkuar rivendikimin e kufijve të Shqipërisë së vitit 1913. Më pas, ai punoi si komisioner special për Shqipërinë

Vatra dhe Dielli kanë qënë të pamëshirshëm ndaj çdo tradhëtie. Në mënyrë të veçantë spikat qëndrimi i përfaqësuesve shqiptarë të Amerikës ndaj Esat Pashës dhe lojrave të tij ndaj çështjes shqiptare. Kështu, në një Memorandum për Presidentin Uillson, vatrën e kundërshtojnë takimin e tij me Esat Pashën duke e konsideruar këtë të fundit një njëri që "nuk përfaqëson askënd tjetër përveçse veten e tij".

3.- **Edith Pierpont Stckney**,<sup>4</sup> edhe kjo një autore amerikane, e cila ka doktoruar në shkencat historike me librin: "Shqipëria e Jugut ose Epiri i Veriut në çështjet Europiane Ndërkombëtare nga viti 1912 deri me 1923", botuar me 1925. Autorja e ka eksploruar materialin e jashtëzakonshëm të Bibliotekës së Huverit në ShBA (koleksioni më i madh në botë rreth Shqipërisë për periudhën në fjalë) dhe ka sjellë tek ne një studim i cili ndonëse nuk mund të thuhet me entuziazëm se është pro-shqiptare për shkak të ftohtësisë së trajtimit të fakteve, prapëseprapë duhet çmuar për shumë të vërteta që janë thënë aty.

Në morinë e fakteve të trajtuara nga Stikney do të desha të ndalem tek përshkrimi që ajo i ka bërë rolit që luajti Vatra jonë si kundërshtarë e denjë dhe bindëse ndaj propogandës greke në Konferencën e Paqës. Ajo çfarë duhet nënvizuar është fakti që rreth 31 organizata Pan-epirote nga ShBA-ja, Anglia, Australia e gjetkë, kishin ndërmarrë një fushatë të ethshme shpifjesh e mashtrimesh mbi të drejtën historike dhe legjitime, që sipas tyre, gëzonin grekët mbi Epirin e Veriut ose mbi Shqipërinë e Jugut. Autorja thotë se në përbërje të këtyre organizatave bënin pjesë gjithfarë pseudo - historianësh, pseudo gazetarësh, fallcifikatorësh, pamfletistësh, karikaturistësh, fotografësh, të cilët mbushnin çdo rrugë kryesore të Parisit me fletushka të cilat shprehnin gjoja padrejtësinë e madhe që u ishte bërë grekëve të Epirit të Veriut. Kësaj lukunie greke i bënte ballë me dinjitet Federata - Pan Shqiptare Vatra si dhe organi i saj Dielli. Ndërsa nga Anglia një grup intelektualësh të shquar anglezë të drejtuar nga e njohura Edith Durham punonte pareshtur sa me Zyrën për Marrëdhënie me Jashtë Angleze aq edhe me mjetet e athershme propogandistike për të bindur opinion publik mbi drejtësinë e kërkesave të shqiptarëve.

Stikney nënvizon faktin që Federata Panshqiptare Vatra e Amerikës që nga formimi i saj me 1909 e deri me 1919 kishte arritur të ndërtonte 72 degë anë e mbanë

---

në Shtetet e Bashkuara në 1920-1921. Ndërkaq, në vitin 1919, i përkrahur edhe nga Noli, Konica, delegacionet shqiptare të Shqipërisë e diasporës, Erikson, hartoi memorandumun e veçantë duke kërkuar nga presidenti Uillson dhe SHBA që ta vendosnin Shqipërinë nën protektoratin amerikan. Në periudhën 1922-1923, gjëndet sërish në Shqipëri, kësaj rradhe si asistent në stafin e Legatës Amerikane në Tiranë. I mbështetur nga qeveria shqiptare, në atë kohë me kryeminister Ahmet Zogun, për të ngritur një kolegji bujqësor, themeloi dy shkolla, një shkollë bujqësore për djemtë dhe një shkollë të arteve shtëpiake të vajzave. Ardhja tjetër në Shqipëri e Eriksonit, ishte në vitin 1937, me rastin e 25 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, ku ai ishte mik i Legatës Amerikane. Edhe pas daljes në pension, Erikson shërbeu si delegat i Federatës Pan-shqiptare të Amerikës në Konferencën e Kombeve të Bashkuara, e cila u mbajt në San Françisko të Kalifornisë në vitin 1945. Vitet në vazhdim do t'i kalonte si pastor në disa nga shtetet e SHBA-së dhe më pas do të fillonte misionet e tij në Kapri, Korfuz, Rodos dhe Britani, derisa u kthye përfundimisht në Kaliforni. Gjatë gjithë këtyre viteve, Erikson nuk e harroi Shqipërinë, por vazhdoi të ishte një nga miqtë saj derisa vdiq në vitin 1966, pasi kishte kaluar 99 vjet jetë të mbushura me aventura. Pesë vjet prej të cilave janë përmbledhur në ditarin e tij për Shqipërinë.

<sup>4</sup> **Edith Pierpont Stckney**, autore e librit studimor për historinë e shqiptarëve, "Shqipëria e Jugut ose Epiri i Veriut në çështjet Europiane Ndërkombëtare 1912-1913". Autorja ka fituar gradën e Doktorit të shkencave historike me këtë studim serioz.

ShBA - se dhe Kanadasë si dhe të botonte gazetën e saj Dielli dhe një revistë mujore të quajtur “Adriatic Review.”

Kjo shoqëri mbajti një delegat në Paris me 1919, Rev. C.Telford Erikson, ish misionar amerikan në Lindjen e Afërt. E dyta për nga rëndësia thotë Stikney, ishte Shoqëria Anglo- Amerikane e themeluar pak para se sa te përfundonte lufta e që kishte si qëllim njohjen e pavarësisë së Shqipërisë. Kjo shoqëri luftonte në dy fronte: atë të botimeve dhe të komunikimit me shtypin dhe Dhomën e Komunave. Nga më të shquarit prej tyre ishte i nderuari Aubrey Herbert<sup>5</sup>, si president dhe Edith Durham,<sup>6</sup> të dy miq të flaktë të Shqipërisë. Përkrah përfaqësuesit të Federatës Pan - Shqiptare Vatra, ishin edhe delegacione të tjera të përbëra prej përfaqësuesish të kolonive nga Stambolli, Rumania dhe territoret e Korçës.

Rëndësinë e veprimtarisë së Vatrës në dobi të çështjes shqiptare e ka shprehur më mirë se kushdo një ndër armiqtë më të mëdhenj të Shqipërisë, Kryeministri i atërkohës grek Venizellos kur deklaronte: “ Ishte Vatra ajo që ma hoqi nga dora Vorio Epirin.”

Vatra është nga ato organizata shqiptare që ka vulosur në historinë e Shqipërisë një emër të artë dhe kjo pikërisht sepse korifejtë e kulturës sonë kombëtare, Noli e Konica, e sa e sa bij të tjerë të Vatrës kanë vënë çdo gjë në shërbim të atdheut. Në këtë pamje, le ta kujtojmë historinë e Vatrës që ajo të përsëritet tek brezat e rinj qofshin të lindur, qofshin të ardhur së voni në Amerikë. Le të luftojmë që në vend të Stefanopollusve që këshillojnë Presidentin e Amerikës se si tu leshojë dorë të lirë grekeve në Jug të Shqipërisë të kemi një Erikson i cili deklaronte në Kongresin Amerikan në vitin 1919 si më poshtë:

*"Tek shqiptarët gjen virtyte të cilat do të ishin të dëshirueshme për shumë popuj të përparuar. Propaganda sistematike i ka paraqitur si armiq të qytetërimit dhe plaçkitës por kjo është vetëm një gënjeshtëri. Une kam jetuar disa vite në mes të shqiptarëve dhe për këtë ndjehem i detyruar të them të vërtetën. Ata janë intelegjentë, fisnikë, punëtorë, e duan jetën familjare, seriozë, mikpritës, besnikë deri në vdekje. Për të tillë popull e kam njohur popullin shqiptar dhe jam krenar që po e përfaqësoj sot këtu".*

<sup>5</sup> **Aubrey Nigel Henry Molyneux Herbert**, anëtar i parlamentit anglez, (1880 – 1923) ishte një diplomat britanik, udhëtar dhe oficer zbulimi i njohur për ndihmesën e dhënë për pavarësinë e Shqipërisë. Ai e kishte vizituar Shqipërinë që në vitin 1907, 1911 dhe 1913. Kur delegatët shqiptarë në Konferencën e Paqes në Ballkan në vitin 1912 siguruan asistencën e Herbertit si një këshilltar i tyre. Ai ishte shumë aktiv në kauzën shqiptare dhe njihet si një njeri që kishte ndikim të konsiderueshëm në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë. Një ndër korrespondentët e tij të përhershëm mbi Shqipërinë ishte Edith Durham. Atij iu ofrua Froni mbretëror i Shqipërisë dy herë. Herën e parë ishte fill përpara Luftës së Parë Botërore. Ai deshi ta merrte atë por ia ktheu mendjen kryeministri Herbert Asquith, një mik i familjes së tij. Oferta mbeti jo zyrtare dhe u refuzua nga Foreign Office. Kurora iu dha më pas Vilhelm Vidit. Më pas iu ofrua në vitin 1920 por përsëri nuk e mori Fronin. Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë në Tiranë njëherë e një kohë mbante emrin e Herbertit ashtu sikundër edhe një fshat në Shqipëri.

<sup>6</sup> **Mary Edith Durham** (1863-1944) ishte një udhëtare britanike, artiste, shkrimtare e cila u bë e famshme për studimet e saj antropologjike për jetën në Shqipëri, në fillimin e shekullit të njëzetë. Edith Durham arriti të identifikojë me kauzën shqiptare dhe u bë kampione e unitetit dhe pavarësisë së popullit shqiptar. Ajo fitoi reputacionin si person i vështirë dhe eksentrik dhe u kritikuar ashpër prej avokatëve të shtetit jugosllav të cilët mbështesnin përfshirjen e Kosovës së populluar prej shqiptarëve brenda Serbisë sllave.



Pikërisht në këtë traditë të Vatrës u zhvillua lufta për Kosovën nëpërmjet përfaqësuesve të popullit amerikan në Kongres, Senat e administratë. E nëse i nderuari Bob Doll u angazhua kaq shumë në çështjen tonë për Kosovën të mos harrojmë se ishin shqiptarët e Amerikës ata që e njohën, bindën dhe vunë në veprim një figurë kaq të nderuar. Kjo është beteja për kauzën tonë kombëtare. Henry Kissinger, vetëm disa ditë para fillimit të bombardimit në Jugosllavi deklaronte hapur se ishte kundër një ndërmarrje të tillë. Por kur Liga Qytetare Shqiptaro Amerikane, në sallën e Kongresit Amerikan i dorëzoi atij librin "**Shpëtimi në Shqipëri**" i botuar nga kjo Ligë dhe i thanë se tek ky libër do të gjejmë një histori të madhe të një kombi që sot rrezikohet si hebretjtë dikur, nuk vonoi dhe doli mbrojtësi më i flaktë i bombardimeve dhe përpjekjeve amerikane për çlirimin e Kosovës.

Në një cikël emisionesh të drejtëpërdrejta televizive të Kanalit CN8 Nju Xhersi kam patur rastin të debatoj me shumë shikues. Një prej tyre më tha: "Ju shqiptarët po na goditni ne serbëve me dorën e Bob Dollit i cili është shqiptar nga origjina." Kjo tregonte se sa afër jemi ndjerë ne shqiptarët me të nderuarin Bob Doll.

Por përkrah tij janë miq të tjerë të shqiptarëve, miqtë e Vatrës dhe të organizatave të tjera shqiptare siç janë Liga Qytetare Shqiptaro Amerikane dhe kongresmenët Gilman, Engell, Kelly, si dhe shumë të tjerë në administratë të cilët janë angazhuar në çështjen shqiptare falë përpjekjeve të shqiptaro - amerikanëve. Kjo përbën pjesën më të shkëlqyer të asaj që Vatra dhe vatanët si dhe shqiptaro - amerikanet në përgjithësi kanë bërë për Kosovën deri tek Presidenti Amerikan.

Historia e Vatrës dhe Diellit bëjnë pjesë në fondin e artë të historisë së përpjekjeve të shqiptarëve në shekullin e fundit të Mijëvjeçarit të Dytë.

**Mal Berisha,**  
**Southern Gate Hotel, Nju Jork**  
**30 Tetor 1999**